

**RAPORT
I KONTROLLIT TË BRENDSHËM
PËR VITIN 2016**

Tiranë, 22 MAJ 2017

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi



I. INFORMACION JURIDIK DHE ORGANIZATIV

Emri : Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

Statusi juridik : Organizatë jo fitimprurëse, rregullator i profesionit.

Selia : Rruga e Elbasanit, Pall Edil Al-It, kati 3, Tiranë.

Themeluar: Me vendim gjykate nr 3573, datë 16 tetor 1998.

Themeluesit: Grupim profesional i Ekspertëve Kontabël dhe shoqërive të auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë: Të sigurojë ushtrimin e profesionit në përputhje me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të antarëve të tij.

Organi më i lartë vendimmarrës: Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Organi Drejtues : Këshilli Drejtues i zgjedhur nga Asambleja e përgjithshme, sot:

- | | |
|----------------------|------------|
| 1. Hysen Çela | Kryetar |
| 2. Eleonora Olli | Zv/kryetar |
| 3. Bujar Osmani | Anetar |
| 4. Shkëlzen Margjeka | Anetar |
| 5. Kledian Kodra | Anetar |
| 6. Doranin Agalliu | Anetar |
| 7. Arqile Mishtaku | Anetar |

Organi Ekzekutiv : Drejtori i zgjedhur nga Keshilli Drejtues dhe miratuar nga Asambleja, Elvira Hoxha.

Organi Mbikqyrës : Bordi i Mbikqyrjes Publike i emëruar nga Ministri i Financave, organizimi i të cilit është rregulluar me Vendim nr 874 datë 12.08.2009.

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

Organe bashkvepruese :

1. **Autoriteti i Regjistrimit pranë IEKA-s**, i cili përbëhet nga 5 anetarë të cilët emërohen nga Ministri Përgjegjës për Ekonominë, organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të nenit 19 dhe 60 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar) si dhe te Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Regjistrimit pranë IEKA, të propozuar nga IEKA dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
2. **Autoriteti i Çertifikimit pranë IEKA-s**, i cili përbëhet nga 5 antarë të cilët emërohen nga Ministri Përgjegjës për Financat, organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të nenit 5 dhe 17 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (i ndryshuar), me Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Çertifikimit të EKR dhe të KM, të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike dhe me shkresën nr 6339/1 datë 28.04.2014 të Ministrit të Financave dhe ndryshohet me vendimin nr 9 date 28/07/2015 te BMP dhe shkresen 13886/1 date 05/10/2015 te Ministrit te Financave.
Instituti është i ngarkuar për të mbajtur librat e llogarive të Autoritetit të Çertifikimit, të cilat mbahen përfshirë në regjistrat e IEKA-s, në llogaritë e klasës 4. (Shënimet e Pasqyrave financiare nr 9). Jane bere edhe pasqyra financiare te vecanta te Autoritetit te Certifikimit.
3. **Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës**, i cili përbëhet nga :
 - Shkëlzen Margjeka Kryetar
 - Teki Flamuri Anetar
 - Elton Tirana Anetarorganizimi i të cilit është rregulluar në bazë të neneve 5,12,14,55,57 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (te ndryshuar) me Rregulloren e Investigimit dhe Disiplinës, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.
4. **Komiteti i Kontrollit të cilësisë**, i cili përbëhet nga:
 - Eleonora Olli Kryetar
 - Arqile Mishtaku Anetar



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2016

- Afrim Suli Anetar

- Fatime Alliu Anetar

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të nenit 38 të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar dhe nenit 15 të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren për Kontrollin e Cilësisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të miratuar nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

5. **Komiteti i Edukimit Profesional**, i cili përbëhet nga:

- Kledian Kodra Kryetar

- Ana Osmani Anetar

- Diana Lamani Anetar

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren e edukimit dhe kualifikimit profesional, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e përgjithshme e antarëve.

6. **Komiteti i Kualifikimit të vijueshëm**, i cili përbëhet nga:

- Doranin Agalliu Kryetar

- Ludmilla Paluka Anetar

- Armand Fehtahaj Anetar

organizimi i të cilit është rregulluar në bazë të Ligjit 10091 datë 05.03.2009 te ndryshuar dhe të Statutit të IEKA-s, me Rregulloren, të propozuar nga Këshilli Drejtues dhe të aprovuar nga Asambleja e përgjithshme e antarëve.

7. **Komitetei i Etikës**, i cili përbëhet nga :

- Bujar Osmani Kryetar

8. **Komiteti i kontrollit të brendshëm**, i cili përbëhet nga Luan Muca dhe Vjollca Dervishi.

Në bazë të Statutit të IEKA-s detyrat e kontrollit të brendshëm janë sipas **nenit 25**:

25.1 Të verifikojë veprimtarine financiare te Institutit, të kontrollojë dhe mbikëqyrë zbatimin e procedurave kontabël, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

llogari me buxhetin si dhe rregullsinë dhe korrektesën e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

25.2 Të propozojë ekspertin kontabël të regjistruar i cili do të auditojë pasqyrat financiare të Institutit dhe të mbajë marrëdhëniet ndërmjet tij dhe personelit të Institutit.

25.3 Bën vlerësimin e situatës financiare të Institutit , bazuar ne raportin e ekspertit kontabël te regjistruar;

25.4 I jep mendimin Këshillit Drejtues për të gjitha problemet që I kërkohen prej këtij të fundit;

25.5 Komiteti I Kontrollit të brendshëm i paraqet Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve një raport vjetor që nënshkruhet bashkërisht nga anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm. Në rast mosmarrëveshje secili anëtarë paraqet vecmas mendimet dhe vlerësimet e tij në Asamblenë e Përgjithsme të Anëtarëve, e cila merr vendimin përfundimtarë në lidhje me çështjen.

II. VEPRIMTARIA FINANCIARE E IEKA

Veprimtaria e IEKA-s rregullohet me ligjet:

- Ligjin “Për tregtarët e shoqëritë Tregtare” ,
- Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar dhe të kontabilistëve të miratuar” te ndryshuar,
- Ligjin për “Organizatrat jo-fitimprurëse” dhe
- Statutin e IEKA-s.

Veprimtaria e IEKA-s konsiston në ndihmesën që u jepet profesionistëve në lidhje:

me ushtrimin e profesionit në përputhje me me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të antarëve të tij.

Kjo ndihmesë iu jepet përkundrejt kuotës vjetore që secili prej antarëve paguan. Konkretisht



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2016

Për vitin 2016 kuotat janë si më poshtë:

1. Kuota fikse 100 000 lekë për çdo anetar aktiv në profesion.
2. Kuota fikse 8 000 lekë për çdo antarë joaktiv në profesion
3. Kuota variabël 0,5 % të vleres se perftuar nga misionet ligjore

Të ardhurat nga kuotat e ndryshme apo trajnimet e realizuara shërbejnë për të mbuluar shpenzimet, të cilat nevojiten për të mbuluar kuotat për pjesmarrje në organizma ndërkombëtar, për mbajtjen e personelit dhe për mbulimin e kostove të shërbimeve që IEKA merr nga të tretët në kryerjen e veprimtarisë së vet.

Veprimtaria e IEKA-s realizohet nëpërmjet organeve drejtuese dhe ekzekutive. Për të realizuar një veprimtari në përputhje të plotë me Ligjet rregullatore Organet drejtuese të saj kanë realizuar një rregullore të brendshme, ku përcaktohen me hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion pune.

Më poshtë po permendim funksionet e Sektorit të Financë kontabilitetit shkurtimisht, meqënëse edhe detyra e KKB fokusohet tek ky sektor:

I paraqet Drejtorit treguesit e projekt buxhetit sipas aktiviteteve.

Llogarit kostot sipas aktiviteteve.

Llogarit pagat dhe honoraret e miratuara nga Këshilli Drejtues.

Mban librat e llogarive dhe realizon kontabilizimin e dokumentacionit.

Llogarit dhe përpilon pagesat e bëra të tretëve, përfshi këtu edhe tatimet.

Mban rregjistrat e punonjësve.

Përgatit dhe analizon raportet financiare mujore e tremujore dhe ia paraqet Drejtorit.

Kontrollon veprimet e arkës.

Rakordon kontributet e secilit antar me deklaratimet e tyre.

Mban përgjegjësi materiale për çdo penalitet tatimor që vjen për faj të saj.

Përgatit Pasqyrat financiare vjetore.

Informon për gjendjen financiare edhe Kryetarin e KD.

III. PROÇEDURAT KONTABËL

Organi Ekzekutiv i IEKA-s ka ndërtuar sistemin e regjistrimeve në kontabilitet, sipas parimeve dhe metodave të njohura kontabël, të cilat janë në përshtatje me Ligjin "Për Kontabilitetin" si dhe në funksion të dhënies së informacioneve mbi realizimin e zërave të parashikuara në buxhetin e miratuar.

Kryerja e shpenzimeve realizohet mbi bazën e domosdoshmërisë së tij, me qëllimin e përdorimit sa më me efektivitet të burimeve.

Çdo shpenzim shoqërohet me dokumentacion bazë justifikues, autorizohet dhe miratohet nga personat përgjegjës.

Drejtori ekzekutiv autorizon shpenzimet e buxhetuara si dhe veprimet që lidhen me pagesat apo tërheqjet nga llogaritë bankare të IEKA-s, brenda kufijëve të përcaktuar nga këshilli i Drejtimit.

Blerjet e mëdha (pajisje zyrash) janë realizuar me miratimin e një Komisioni blerje, i cili përbëhet nga 3 antarë, miratuar nga Keshilli Drejtues.

Blerjet me lekë në dorë verifikohen nga Financieri dhe paguhen nga Arkëtari dhe në çdo rast kanë 3 firma.

Organet ekzekutive planifikojnë që në fillim të vitit buxhetin për blerjen e çdo lloji pajisje, malli apo shërbimi.

Çmimet e materialeve të trajnimit apo të çdo shërbimi tjetër që iu bëhet antarëve të Institutit apo edhe të tretëve, përllogariten për çdo shërbim më vehte.

Financieri ndjek arkëtimin e kuotave fikse dhe variabël të antarëve si edhe të të ardhurave të tjera si kurse trajnimi, regjistrime të reja, botime, e të tjera.

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2016

IV. PAJTUESHMËRIA E LLOGARIVE ME BUXHETIN

Në tabelën e mëposhtme janë evidentuar Buxheti i planifikuar për vitin 2016 dhe realizimi i tij në vlerë absolute dhe në përqindje përkundrejt buxhetit të planifikuar:

	Zerat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 2015	Buxheti Miratuar 2016	Realizimi Buxhetit 12M 2016	% ndaj Buxhetit
1	Burimet	33,673,509	30,250,000	34,194,711	113
1.1	Burime financiare nga Aktiviteti	30,208,171	27,750,000	30,347,323	109
	Kuota fikse e anetaresimit	22,403,873	22,000,000	22,252,780	101
	Kuota variable e misioneve	4,711,033	3,250,000	3,899,444	120
	Te ardhura nga regjistrimi stazhiereve	1,750,000	2,000,000	2,550,000	128
	Te ardhura te tjera & Regj. Shoqerive)	1,343,265	500,000	987,599	198
	Te ardhura Regj. Ne provime			657500	
1.2	Burime te ardhurash te tjera	3,465,338	2,500,000	3,847,388	154
	Burime (te ardhura) nga Botimet	701,400	200,000	219,800	110
	Burime (te ardhura) kual. EKR & Stazh.	1,479,350	1,800,000	1,784,500	99
	Burime nga trajnimi i SKK/SNK	597,700		626,000	
	Te ardhura nga depozitat e kursimeve	673,529	500,000	1,113,370	223
	Fitime/humbje kursi kembimit	14,059		103,718	
2	Perdorime (Shpenzime)	27,684,919	37,894,000	30,238,121	80
2.1	Shpenzime nga veprimtaria	22,375,760	31,374,000	21,757,313	439
2.1.1	Pagat e punonjesve	5,701,296	7,615,000	4,807,985	63
	Pagat e personelit me kohe te plote	5,149,455	6,750,000	3,579,275	53
	Sigurime shoqerore	551,841	865,000	469,650	54
2.1.2	Honorare te Drejtimit	4,122,000	4,152,000	3,813,000	92
	Honorare te KD & drejtimit perditshem				91



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm Viti 2016

		3,942,000	3,972,000	3,633,000	
	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	180,000	180,000	180,000	100
2.1.3	Honorare per Autoritete e Komitete	1,603,200	4,430,000	1,903,760	43
	Autoriteti i Regjistrimit	364,500	400,000	209,000	52
	Komiteti i Investigimit & Disiplines	66,000	500,000	376,000	75
	Komiteti i Edukimit të Kandidatëve	270,700	500,000	280,000	56
	Komiteti i Kualifikimit të Vijueshëm		250,000	22,000	9
	Komiteti i Kontrollit të Cilesise	902,000	1,280,000	1,005,000	79
	Komiteti për kthim rishikim të Stand. Prof		600,000		0
	Komiteti i Etikes dhe të tjera		100,000		0
	Bordi i Mbikqyrjes Publike		800,000	11,760	1
2.1.4	Shpenzime të Administrimit	9,965,560	14,077,000	10,465,158	74
	Telefon, Fax, shpenzime interneti	426,112	700,000	319,293	46
	Mirembajtja e regj. publik & faqes inter.		200,000		0
	Energji, Uje.	295,964	300,000	232,010	77
	Kancelari, Shtypshkrime, riparime	127,000	350,000	364,909	104
	Reklama, Publicitet , Njoftime		60,000		0
	Abonime, Gazeta, revista		50,000		0
	Udhetime e Djeta	1,664,739	2,200,000	2,027,186	92
	Karburant e rip. të zakonshme	167,640	450,000	243,850	54
	Taksa, sigurime e parkim automjetesh	229,295	157,000	165,307	105
	Shpenzime pritjeje	54,320	250,000	118,670	47
	Sherbime në të trete	442,430	500,000	438,730	88
	Regjistrime në organet lokale	28,272	30,000	40,930	136
	Shpenzime për kom. Bankare	49,911	80,000	82,106	103
	Kuota anetaresimi Org. Nd/kombetare	1,277,420	2,000,000	2,003,850	100
	Pjesmarrje në Kon. E 71 OEC/CNCC		450,000	478,270	106
	Shpenzime të tjera	414,328	500,000	111,772	22
	Shpenzime për Asamblene	865,606	1,800,000	1,016,500	56
	Shpenzime Udhetime turistike				
	Auditimi i PF	168,660	200,000	165,948	83
	Shpenzime amortizimi	3,753,863	3,500,000	1,988,913	57
	Shpenzime për provizione			581,794	

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

	Shpenzime te paparashikuara Aktiviteti		300,000	85,120	28
2.1.6	Rezerve e KD gjithsej		100,000	100,000	100
2.2	Shpenzime per botime	300,9333	4,320,000	63,284	1
	Botimi i Revistes	165,755	620,000	39,194	6
	Shpenzime per botime te tjera	135,178	200,000	24,090	12
	Pershtatja – Programi Pack PEE		3,500,000		
2.3	Shpenzime per kualifikimin	2,870,518	2,200,000	2,912,296	132
	Shpenzime kualifikimi i stazhiereve	1,342,510	1,100,000	1,341,820	122
	Shpenzime kualifikimi i e.k.r.	1,105,908	1,100,000	1,183,476	108
	Shpenzime trajnimi i SKK/SNK	422,100		378,000	
2.4	Fitime/humbje kursi kembimit	2,008		2,978	
2.5	Aktiviteti sipas vendimit te Asamblese	2,135,7000		5,502,250	
3.1	Teprica nga veprimtaria kryesore	7,832,411	-3,624,000	8,590,010	
3.2	Teprica nga publikimet	400,467	-4,120,000	156,516	
3.3	Teprica nga kualifikimi EKR & Stayh.	-794,168	-400,000	-501,796	
3.4	Teprica nga depozitat e kursimeve	673,529	500,000	1,113,370	
3.5	Teprica nga kursi i kembimit	12,051	0	100,740	
	Teprica Total	5,988,590	-7,644,000	3,956,590	
Teprica total perfshire Investimin AAM		6,972,294	-6,644,000	4,624,000	

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 dhe realizimi i tij në vlerë absolute dhe në përqindje përkundrejt buxhetit të planifikuar për blerjet e aktiveve afatgjata materiale, është realizuar si më poshtë:

2.1.5	Investime, Meremetime	983,704	1,000,000	667,410	67
	Investime (blerje AAM)	983,704	1,000,000	667,410	67

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

Sikurse vihet re Burimet financiare nga aktiviteti janë realizuar krahasimisht me parashikimin në masën 109%. Kanë ndikuar ndjeshëm në këtë rritje Të ardhurat nga kuota variabël në masën 120%, të ardhura nga regjistrimi i shoqërive në masën 198%, të ardhura nga regjistrimi i stazhierëve në masën 128%.

Masa e realizimit të këtyre zërave krahasimisht me buxhetin, si edhe me një vit më parë tregon ecuri të mirë në aktivitetin e IEKA-s. Nisur nga fakti që ne zerat e të ardhurave buxheti është me i vogël se realizimi i vitit 2015, vërejmë se buxhetimi i të ardhurave është bërë me rezerva.

E kundërta ka ndodhur me realizimin e zërave të shpenzimeve, që në totalin e vet janë realizuar vetëm 80% e shpenzimeve të buxhetuara. Por kjo situatë na lë detyrën për të qënë më të kujdesshëm në hartimin e buxhetit.

- Rritje e shpenzimeve shihet në pak zëra, dhe konkretisht:
- Shpenzime për kualifikimin është realizuar në masën 132 % .
- Shpenzime të paparashikuara janë kryer për provizionim 581 794 lekë , aktivitetin Trajnimit për 387 000 lekë, si dhe aktiviteti turistik për 5 502 250 lekë. Por për këto shpenzime ka vendosur këshilli Drejtues.

Vërejmë se:

- Janë buxhetuar 4.430.000 lekë për Honorare për autoritete e komitete, ndërkohë që janë shpenzuar për çdo zë të tyre shumë më pak se buxhetimi, duke kapur në total vlerën 1.903.760 leke, pra vetëm 43% e tyre.
- E njëjta gjë ka ndodhur me shpenzimet e administrimit, e cila është realizuar vetëm 74%.
- E njëjta gjë ka ndodhur me shpenzimet e pagave, të cilat janë realizuar vetëm ~~68%~~ 63%.

V. KORREKTËSIA E LLOGARIVE TË APROVUARA NGA KD

Pasqyrat financiare të vitit 2016, të evidentuara më 31.12.2016 janë hartuar nga Financieri Alida Daija, janë autorizuar nga Drejtori Ekzekutiv Zj, Elvira Hoxha dhe janë audituar nga

INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

Ekspertet Kontabël të caktuara me këtë mision me Vendim Asambleje znj. Mirjeta Emini dhe znj. Rajmonda Reveli, të cilat arritën në opinionin:

“Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKA më 31 dhjetor 2016 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me politikat kontabel te pershtatura nga KD dhe Asambleja e Pergjithshme e Anetareve te cilat jane bazuar ne SKK dhe vecanerisht ne Standartin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF).”

Pasqyrat financiare 2016 janë autorizuar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr.23, datë 28.04.2017 dhe nënshkruar në emër të tij nga Kryetari Z. Hysen Çela.

VI. VLERËSIMI I SITUATËS FINANCIARE

Sikurse shihet në pasqyrat financiare Aktivitet e evidentuara kapin vlerën 125.513.142 lekë, nga të cilat 14.303.401 lekë janë detyrime, duke lënë diferencën prej 111.209.741 lekë në Aktivitet Neto, ndërkohë që rezultati vjetor shënon tepërisht burimesh në ritje të Aktiveve neto në vlerën prej 4.624.001 lekë.

Burimet e krijimit të këtyre aktiveve rezultojnë të jenë në masën 87,13% të IEKA-s dhe 12,87 % janë detyrime ndaj të tretëve. Detyrim ndaj Autoritetit të Çertifikimit është rritur këtë vit duke kapur shifrën 6.755.739 lekë ose 47.24 % të detyrimeve.

KONSTATIME

1. Gjate kontrollit te shpenzimeve për vitin 2016 nuk u konstatuan vërejtje për procedurat e blerjeve.
Këto procedura jane perfshire ne rregulloren e miratuar nga KD me vendim Nr. 33 date 05,11,2014 , hyrën ne fuqi në 01.01.2015 dhe kanë gjetur zbatim gjatë vitit 2016.
2. Detyrimet e llogaritura në 2014 por të papaguara ende, për Bordin e Mbikqyrjes Publike për 840 000 lekë, kontabilizuar me Vendimin e KD nr 44 datë 24.12.2014, nuk gjejnë ndryshim gjatë vitit 2016.



INSITUTII EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm
Viti 2016

3. U konstatua se në librat e llogarive të mbajtura në Programin informatik "Alpha" janë korrigtuar paraqitjet kontabël, duke mundësuar raportimin financiar direkt nga programi, pa ndihmesën e tabelave në exel.
4. U konstatua se ka Debitorë (antarë të IEKA-s) që nuk kanë likjuar detyrimet e tyre për më tepër se një vit.

REKOMANDIME

1. Shërbimet nga Instituti çdo anetar i merr në mënyrë të barabartë, prandaj edhe në likuidimin e detyrimeve duhet të jemi të barabartë.
Bazuar në Statutin e IEKA-s, kapitulli VII, pika 29.4 ku thuhet " Në rast të mospagimit të kuotës për një periudhë për më shumë se 6 muaj, KD ka të drejtë ti propozojë Bordit të Mbikqyrjes Publike, pezullimin e Ekspertit Kontabël nga Regjistri Publik", duhet që Ekzekutivi i Institutit të bëjë një punë më konkrete për mbledhjen e detyrimeve dhe propozojë masa për anëtarët që nuk paguajnë kuotën.
2. Të shfrytëzohet fondi për botime, me qëllim ardhjen në ndihmë të antarëve, për botime të herëpashershme në lidhje me aplikimin e standarteve, kuptimin e ligjeve në përdorim, edhe pse mund të kalohet në përsëritje të shkrimeve të viteve të mëparshme.

PROPOZIME

Duke qënë se teprica e krijuar gjatë vitit 2016 dhe gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2016 është pothuajse sa dyfishi i kostove vjetore, ne dalim me propozim për:

Uljen e kuotës fikse nga 100.000 lekë në 80.000 lekë për çdo anëtar.

PËR KOMITETIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Luan Muça

Vjollca Dervishi



Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Luan Muça
Vjollca Dervishi